



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____ р./в.



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 12/19) dhe nenit 40 paragrafi 1 nga Rregullorja për punës e komisionit shtetëroro për parandalim të korrupsionit, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit duke vepruar për lëndën pas denoncimit nga parashtrues i panjohur (denoncim anonim), në vazhdimin e seancës 42-të të mbajtur me datë 14.12.2020 morri:

VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-5513/1 me datë 04.12.2019 është e formaur sipas denoncimit anonim, **NDËRPRITET**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror përparandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm në lëndëm me numër 12-5513/1 me datë 04.12.2019, përshkka se akuzat në denoncim nuk janë vërtetuar

Lënda me numër 12-5513/1 me datë 04.12.2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK, me sqarimin, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web-faqen e KSHPK në afat prej 5 (pesë) ditë nga dita e vendimmarrjes

Sqarim

Lënda me numër 12-5513/1 me datë 04.12.2019 formaur pas denoncimit të dorëzuar nga parashtrues i panjohur (denoncim anonim).

Në denoncim tregohet për akuzat për dyshme për parregullësi në procedurën për punësim të personi, përndryshe i biri i d-r në SHSHP Klinika Universitare për Shkup, si dhe akuza për dyshime për parregullësi në procedurën për zgjedhje për titullin docent i d-r në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, përndryshe Drejtor i SHSHP Klinika Universitare Shkup.

Me qëllim të caktimit të gjendjes faktike në rastin konkret, KSHPK dorëzoi Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-1885/1 me datë 06.05.2020 me të cilën kërkon nga SHSHP Klinika Universitare për psikiatri dhe cilët vende të punës janë krijuar / ndryshuar me të njëjtën, të dorëzohen kopje nga ndryshimi i këtij akti dhe të dorëzohen kopje nga dokumentacioni i plotë për realizimin e procedurës për punësim të personit në SHSHP Klinika Universitare për (shpallja publike, procesverbalet nga Komisioni për realizim të testimit dhe nga realizimi i intervjuës me kandidatët të cilët janë paraqitur në shpallje dhe Vendimi për zgjedhje të kandidatit më të volitshëm)

Nga Inspektorati shtetëror i arsimit me Kërkesë për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve me numër 12-1885/2 me datë 06.06.2020 kërkoj të bënë inspektim të jashtëzakonshëm në procedurën për zgjedhje në titullin Docent të d-r në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, dhe në lidhje me atë:

- Vallë në procedurën e thënë janë respektuar rregullativat nga Ligji për arsim të lartë, Statusi i Fakultetit dhe Rregullorja për kushte të veçanta dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesiona dhe tituj bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, si dhe të dhëna tjera relevante në lidhje me procedurën e përmendur për zgjedhje në titull dhe për rezultatet nga inspektimi i jashtëzakonshëm i bërë të informohet KSHPK.

Në afatin e caktura ligjor janë dorëzuar përgjigjet nga SHSHP Klinika Universitare për psikiatri dhe nga Inspektorati shtetëror i arsimit.

Pas kontrollimit të akuzave në denoncim dhe përgjigjet e fituara nga institucionet kompetente, KSHPK e caktori gjendjen faktike vijuese:

Inspektorati shtetëror i arsimit kreu inspektim në bazë të nenit 2 paragrafit 2, nenit 9 pika 6 dhe nenit 21 dhe nenit 31 paragrafi 1 nga Ligji për inspektim të arsimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 52/05, 81/08, 148/09, 57/10, 51/11, 24/13, 164/13, 41/14, 33/15, 145/15, 30/16 dhe 64/18) nenit 206 paragrafi 3 nga Ligji për arsim të lartë, par dorëzimit të Kërkesës për mbledhje të të dhënave dhe informacioneve nr. 12-1885/2 me datë 06.05.2020 KSHPK.

Në bazë të nenit 110 dhe 171 nga Ligji për arsim të lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 82/2018) dhe nenit 26 nga Rregullorja për kushtet e veçanta dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, tituj bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" Shkup, (Zëri Universitetit, nr. 411/2018), Këshilli mësimor-shkencor i fakultetit të Mjekësisë në Shkup, morri Vendim për shpallje të konkursit nr. 02-505/2 me datë 06.02.2029 dhe atë për lëndët nga fusha e mësimor-shkencor

Në bazë të nenit 172 nga Ligji për arsim të lartë dhe nenit 26, 27 dhe 28 nga Rregullorja për kushte të veçanta dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Këshillin e Universitar të fakultetit nr. 02-754/60 me datë 20.02.2018, 02-3159/55 me datë 03.07.2018 dhe 02-505/2 me datë 06.02.2019, Dekani i Fakultetit të Mjekësisë shpalli Konkurs për zgjedhje të personave në të gjitha titujt mësimor-shkencor, shkencor, tituj bashkëpunorësh në gazetata ditore "Veçer" dhe "Koha" me datë 07.02.2019, për lëndët të cilat janë të lartshënuara.

Në konkursin e shpallur në afatin e paraparë u paraqit një kandidat, d-r, bashkëpunor shkencor në Katedrën për të fakultetit të Mjekësisë në Shkup.

Në bazë të nenit 110 dhe 173 nga Ligji për arsim të lartë dhe nenet 8, 30, 33, 34, 35 dhe 36 nga Rregullorja për kushte të veçanta dhe procedura për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunorësh dhe demonstrator në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" Shkup (Zëri Universitetit, nr. 411/2018) Këshilli Mësimor-shkencor në Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, morri Vendim nr. 02-1248/6 me datë 15.03.2019 për formimin e Komisionit recenzues për zgjedhje të 1 (një) punëtor (mësues) në të gjitha titujt mësimor-shkencor për lëndët nga fusha e mësimor-shkencor në përbërje të:

Prof d-r, profesor i rregullt në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij"- Fakulteti i Mjekësisë në Shkup, për lëndën

Prof d-r, profesor i rregullt në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" – Fakultetin e Mjekësisë në Shkup, për lëndën

Prof d-r, profesor i rregullt në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" – Fakulteti i Mjekësisë në Shkup, në fushën mësimor-shkencor:

Komisioni recenzues dorëzoi me shkrim Referat/Raport me Përfundimin dhe propozon deri te Këshilli mësimor-shkencor i fakulteti të Mjekësisë në Shkup, se bashkëpuntori i ri d-r posedon kualitete shkencore dhe profesionale dhe sipas Ligjit për arsim të lartë dhe Rregullores për kushte të veçanta dhe procedura për zgjedhje në të gjitha titujt, mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, i plotësoi kushtet që të zgjedhet në titullin Docent në fushën e mësimor-shkencor Referati është publikuar në Bilten nr. 1190 me datë 15.04.2019 në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" – Shkup dhe kundër referatit të publikuar në afatin e paraparë nuk u dorëzua ankesë.

Në bazë të nent 110 dhe 173 nga Ligji për arsim të lartë, neni 42 paragrafi 2 nga Rregullorja për kushte të veçanta dhe procedura për zgjedhje në të gjithë titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe tituj bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" – Shkup (Zëri Universitetit, nr. 411/2018) Këshilli mësimor-shkencor i Fakulteti të Mjekësisë pran Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup në seancës XXVIII të mbajtur me datë 10.05.2019, morri Vendim për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor nr. 02-2170/36 me datë 10.05.2019 me të cilën është zgjedhur d-r në titullin Docent në mësimor-shkencor për lëndët nga fusha e mësimor-shkencor:

Inspektorati shtetëror i arsimit vërtetoi se procedura për zgjedhjen e d-r në titullin docent në fushën mësimor-shkencor për lëndët në fushën e mësimor-shkencor në Fakultetin e Mjekësisë në kuadër të Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, realizuar pas konkursit të shpallur në përputhje me Ligjin për arsim të lartë (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 82/18) dhe Rregullores për kushte të veçanta dhe procedurë për zgjedhje në të gjitha titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe titujt bashkëpunorësh dhe demonstratorë në Universitetin "Shën Qirili dhe Metodij" në Shkup, (Zëri Universitetit nr.411/2018).

Në lidhje me akuzat për parregullsi në procedurën e realizuar për punësim të personit , përndryshe i biri i d-r në SHSHP Klinika Universitare për Shkup, nga përgjigjet e marrura nga Klinika, KSHPK konstatoi këtë:

Me datë 28.12.2018 Këshilli Drejtues në SHSHP Klinika Universitare për Shkup miratoi Rregullore për sistematizim të vendeve të punës në SHSHP Klinika Universitare për psikiatri – Shkup vulosur me numër 02-539/4 me datë 28.12.2018 për të cilën është marrë pëlqim nga Ministria për shoqëri informatiek dhe administartë vulosur me numër 12/6-60/2 me datë 14.01.2019.

Vendi i punës është paraparë me numër rendor 37 në repartin për vazhdim të shërimit të personave me sëmundje kronike shpirtërore në kushte të spitalit ditor (Qendra për shëndet psiqik).

Rregullora e sipër-përmendur për sistematizim të vendeve të punës në SHSHP Klinika Universitare për janë bërë këto ndryshime dhe plotësime:

Rregullore për ndryhime dhe plotësime të Rregullore për sistematizim të vendeve të punës në SHSHP Klinika Universitare për Shkup, vulosur me numrë 02-518/6 me datë 04.11.2019, për të cilën është marrë Pëlqim nga Ministria për shoqëri informatike dhe administratë nr. 12/6-60/7 me datë 14.11.2019, dhe

Rregullore për ndryshime dhe plotësime të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në SHSHP Klinika Universitare për Shkup, vulosur me nr. 12/6-42/1 me datë 03.01.2020.

Me datë 20.08.2019 SHSHP Klinika Universitare për Shkup dorëzoi Kërkesë deri në Ministrinë e shëndetësisë për marrjen pëlqimit financiar për punësim në vendin e punës psikolog 2 ekzekutor dhe vendin e punës 1 ekzekutor, vulosur me numër 18-7817/2 me datë 26.09.2019.

Me datë 01.11.2019, në gazetata ditore "Nova Makedonija" dhe "Koha", është publikuar shpallës për punësim të 1 dhe 1

Për vendin e punës dhe vendin e punës u paraqit nga një kandidat.

Me datë 13.11.2019 u përgadit procesverbali nga Komisioni për selektim të kandidatëve, vulosur me numrë 02-512/2 me datë 13.11.2019.

Me kandidatët e paraqitur të cilët i plotësuan kushtet është bërë testim me shkrim dhe është përgaditur rang listë, vulosur me numër 02-512/3 me datë 29.11.2019, e cila është dorëzuar deri në drejtorin e SHSHP Klinika Universitare për Shkup.

Me datë 05.12.2019, drejtori i SHSHP Klinika Universitare për Shkup kreu intervju me dy kandidatët e ranguar (1 dhe 1) dhe morri Vendim për zgjedhje të kandidatëve për punësim në kohë të pacaktuar, vulosur me numër 02-512/4 me datë 05.12.2019.

Duke pasë parasysh të gjithë të shënuarën më sipër, KSHPK konstatoi se në lidhje me akuzat për procedurën për zgjedhje në titullin mësimor-shkencor në Fakultetin e Mjekësisë Shkup, është paraqitur vetëm një kandidat i cili sipas asaj që vërtetoi organi kompetent shtetëror (Inspektorati shtetëror i arsimit) i plotësoi kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të definuara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregullores dhe procedurës për zgjedhjen e tij është realizuar në përputhje me ligjin dhe aktet nën-ligjore. Në lidhje me akuzat për parregullësi në procedurën për punësim të personit në SHSHP Klinika Universitarer për Shkup, në të cilën është paraqitur një kandidat në vendin e punës KSHPK konstaton se procedura ka qenë realizuar në përputhje me rregullat ligjore. Prej këtui, KSHPK përfundon se nuk janë vërtetuar akuzat në denoncim dhe nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin konkret.

pas përfundimit të seancës së KSHPK

punoi: m-r I.L

miratoi: m-r Sh.S., anëtar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ KОРРУПСИОНИТ
Kryetar: Biljana Ivanovska